



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 43
Prishtinë, më 04.07.2019
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Albert Kinolli, Emilija Rexhepi, Etem Arifi, Mërgim Lushtaku, Avdullah Hoti dhe Ali Lajçi.

Munguan: Andin Hoti, Verica Qeraniq, Faton Topalli dhe Valon Ramadani.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Flaka Hajdini.

I ftuar: Përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, Ministri z. Rasim Demiri, sekretari z.Fatos Qerimi, Metish Birdaini dhe Amil Kaplani. Nga ZKM-ja, Haki Shatri, Fitim Sadiku, Valdet Gjinovci dhe Ivan Millojeviç.

Pjesëmarrës të tjerë: Florim Beqiri, Erëmira Bytyqi Pllana, Behar Haliti dhe Marigona Berisha.

Rendi i Ditës

- 1.Miratimi i rendit të ditës;**
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.6.2019;**
- 3.Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, i ftuar ministri z. Rasim Demiri;**
- 4.Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të ZKM-së për vitin 2018;**
- 5.Të ndryshme.**

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.6.2019;

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 21.06.2019, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të PVF-ve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018;

Driton Selmanaj, kryetar, bëri të ditur se në mbledhje i pranishëm është ministri i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, z. Rasim Demiri, kurse deputet raportues është deputetja, Emilija Rexhepi. Të pranishëm në mbledhje janë edhe përfaqësuesit e ZKA-së, të cilët e kanë përpiluar raportin për MZHR-në.

Emilija Rexhepi, pasi mori fjalën theksoi se ajo gjatë raportit do të fokusohet tek të gjeturat që ka dhënë Auditori i përgjithshëm, për financat e kësaj Ministrie. Te investimet kapitale dhe tek subvencionet. Siç e keni në raport, kemi shumë parregullsi tek investimet kapitale në shumën prej 2 milion euro, po ashtu, ka shumë parregullsi në proceset e aplikimit të subvencioneve, kemi shumë raste që janë keqpërdor. Nepotizmi në këtë Ministri është shumë i theksuar, ka shumë shkelje në financimin e projekteve të ndryshme si OJQ ashtu edhe individuale. Shumica e përfituesve janë e anëtar të partisë VAKAT. Për shembull do ta përmend njërin nga ta që është Fikret Cezairi, i cili ka pasur një mbështetje të madhe financiare nga kjo Ministri, ku në një rast është mbështetur edhe vajza e tij Alina Cezairi. Po ashtu, keni edhe një rast ku ka qenë përfitues edhe z. Seat Shabani, i cili ka qenë në listën e zgjedhjes në partinë e z. Rasim Demiri, dhe në një rast ka përfituar edhe bashkëshortja e tij, pastaj përfitues ka qenë edhe Adnan Demiri, po ashtu i partisë tuaj, shef i policisë së rajonit, shoku i ngushtë i shefit tuaj të kabinetit Amil Kapllani, vajza e komandantit të policisë së Reçanit z. Xhemalj Asllani, ka përfituar një grand të madh, pastaj është rasti i Elseno Kurtishit nga Lubinja e Poshtme, të cilit fillimisht ja keni dhënë grandin dhe më pas ai e ka hapur firmën, ndërsa ka edhe plot raste të tjera. Të gjitha këto raste unë do t'i vendos në raport me shkrim dhe të gjitha këto të dhëna dhe dokumente janë në administratën e juaj.

Kryetari, paraqiti vërejtje se që nga 30 tetori i 2018, komisioni ka kërkuar nga MZHR-ja që t'ju dërgojë një raport rreth buxhetit të ministrisë dhe mënyrës se si buxheti shpenzohet në ndarjet për grande dhe subvencione, por komisioni nuk ka marrë asnjëherë përgjigje apo informatë.

Rasim Demiri, ministër i MZHR-së, tha se i vjen mirë që është pjesë e këtij diskutimi për raportet e përgatitura nga ZKA-ja, dhe shpreson që deputetët të kenë arritur t'i lexojnë të gjitha raportet e auditorit të jashtëm për të gjitha ministrinë dhe ta shohin që ky raport është raporti më i mirë deri më tani, pa ndonjë të gjetur shumë serioze, përveç disa të gjeturave që janë kryesisht teknike, që vinë si rrjedhojë që ministria është formuar shumë vonë, e gjithashtu ka edhe lëshime teknike për shkak të organogramit dhe mungesës së punëtorëve.

Ministri potencoi faktin se është ftuar nga komisioni për t'i diskutuar të gjeturat nga Raporti i Auditorit Gjeneral dhe jo për të përmendur emra apo mbiemra dhe se asnjë emër dhe e gjetur që u përmendën nga deputetja Emilija Rexhepi, nuk gjenden në raport, për këtë arsyeje nuk mund të përgjigjet. Gjithashtu, ai tha se sa i përket disa shifrave që nuk janë fare në këtë raport nuk mund të përgjigjet.

Ministria i ka disa të gjetura të Auditorit Gjeneral për të cilat ministri do përgjigjet, por nëse vazhdohet të diskutohet për çështjet e ngritura nga deputetja atëherë do kalohet në tema tjera dhe ministri mendon se nuk është ftuar për pyetjet e deputetes të cilat nuk janë as në raport.

Kryetari, theksoi faktin se deputetët kanë të drejtë që të ngrisin çështjet në lidhje me financat publike dhe formën e shpenzimit të parasë publike. Ndërsa, sa i përket kërkesave të komisionit për të dërguar raportet, ministri mohon të ketë pranuar e-mail nga ana e komisionit, por kjo çështje mbetet të konfirmohet.

Ministri pyeti nëse e-maili i është dërguar vetëm sekretarit apo edhe ministrit.

Kryetari, tha se Komisioni herën e parë e ka kontaktuar ministrinë me letër postare, ndërsa herën e dytë përmes e-mailit.

Ministri i MZHR, tha se Ministria e ka ndërruar objektin dhe ndoshta kjo ka qenë arsyeja pse nuk kanë pranuar letër postare.

Emilija Rexhepi, theksoi se për sqarim ndaj ministrit, Komisioni e shqyrton parandë publike dhe keqpërdorimin e parasë publike, prandaj që të gjitha argumentet që u prezantuan më herët do të dërgohen me shkrim. Sa i përket komisionit vlerësues, në dy rastet nga mostrat që i ka pasur auditori gjeneral, i njëjti zyrtar i ministrisë që ka qenë në komisionin vlerësues, është caktuar edhe menaxher i kontratës dhe kjo paraqet konflikt të interesit.

Rasim Demiri, ministër i MZHR-së, theksoi se çështja nuk qëndron në faktin se a e ka kuptuar ministri Raportin e Auditorit të jashtëm, dhe thekson se është në gjendje të përgjigjet për çdo dyshim nga anëtarët e komisionit pavarësisht a është pyetja logjike apo jo.

Sekretari i MZHR-së, u ndal te dy të gjeturat që janë marrë prej rreth 24 lëndëve që ZKA-ja i ka marrë. Bazuar në Ligjin e prokurimit, sekretari e di që menaxheri i kontratave nuk duhet të jetë edhe në komisionin vlerësues, por kjo ka ndodhur për shkak se ministria është e re dhe ende nuk ka staf të mjaftueshëm, dhe për këtë arsye ka pasur raste që zyrtarë të njëjtë janë paraqitur në komisione të ndryshme, kontratat nuk janë me vlerë të madhe por as nuk ka pasur rast të konfliktit të interesit. Kjo ka ndodhur vetëm për arsye formale dhe procedurale për një mbikëqyrje më të mirë të procesit. Dy të gjeturat janë duke u adresuar dhe është hartuar plani i veprimit të rekomandimeve të auditorit.

Kryetari, tha se çështja e dytë që ka të bëjë me të gjeturën ku Komuna e Prizrenit, si aplikuese për projektet "Ndërtimi i infrastrukturës në fshatrat e Lumëbardhit dhe Podgorit", si dhe "Rregullimi i terreneve sportive dhe objekteve kulturore në Rajonin e Lumëbardhit"- dhe Komuna e Mitrovicës aplikuese për projektin "Ndërtimi i rrugës dhe kanalit Suhodoll-Mitrovicë", ishin përzgjedhur si përfituese të projekteve pa ofruar projektin ideor dhe dokumentet pronësore-juridike.

Vlera e këtyre marrëveshjeve të nënshkruara për financim nga MZHR-ja ishte 430,000 €. Pse ka ndodhur kjo, pa pasur asnjë projekt ideor?

Sekretari i MZHR-së, tha se Ministria e bën thirrjen publike në çdo fillim viti për projektet kapitale në të cilën përcaktohen edhe kriteret, po ashtu ekziston edhe një aplikacion, të cilin komunat e shkarkojnë dhe e plotësojnë, ku duhet të potencohet natyra e projektit. Ky aplikacion supozohet të jetë edhe plani ideor më pas në fazën e tenderimit komuna e përcjell edhe planin e detajuar. Kjo nuk aplikohet vetëm te komuna e Prizrenit dhe e Mitrovicës, por te të gjitha komunat.

Albert Kinolli, theksoi faktin se deputetët janë përfaqësues të popullit dhe njëkohësisht janë edhe pjesë e komisioneve. Paratë janë para të taksapaguesve kosovarë dhe detyra kryesore e komisionit është të monitorojë shpenzimin e parasë publike, duke u bazuar në raportet e ZKA-së. Deputeti Kinolli kërkoi nga deputetët që diskutimi mos të zhvendoset në planin individual.

Avdullah Hoti, vuri në pah faktin se Ministria ka një buxhet diku rreth 4-5 milionë dhe dëshiron të dijë më saktë rreth fushëveprimit të ministrisë. Deputeti Hoti rolin e ministrisë e kupton si institucion që ndihmon komunitetet në nevojë dhe komunat që janë më pakë të zhvilluara. Kjo nënkupton që ministria të ketë të dhëna për 38 komunat e Republikës së Kosovës dhe të bëhet një emërore që radhitë komunat sipas nevojave ekonomike, arsimore, sociale. Ky dokument duhet të bëhet publik dhe të jetë në dispozicion të komisionit, dhe vetëm në bazën e këtyre indikatorëve të bëhen thirrjet për financimin e projekteve mbi kriteret të qarta. Shqetësim tjetër është mosprotokollimi i faturave sipas kërkesave të thesarit dhe kërkesave ligjore dhe mosinventarizimi i pasurisë së ministrisë.

Ministri i MZHR-së, theksoi se kur është formuar ministria është formuar me idenë që të krijohet një ekuilibër në komunat apo fshatrat në të cilat nuk ka pasur pothuajse fare investime. Në regjion ka praktika të ngjashme dhe këto ministri kanë një rol shumë të rëndësishëm. Dhe, kur ministria bën shpallje publike mundohet të arrijë këtë ekuilibër, por ka raste kur një komunë ka kërkuar më shumë e ndonjë më pak. Arsyeja se pse Prizreni është përfshirë pak më shumë, është se ka dorëzuar më shumë kërkesa dhe se ka një shtrirje më të gjerë rurale.

Sekretari i MZHR-së, tha se Ministria është themeluar në vitin 2017 dhe në vitin 2018 është miratuar koncepti dokumenti për zhvillim rajonal, ndërsa tani ministria po përgatit planin strategjik për zhvillim rajonal, i cili mendohet që në muajt tetor-nëntor të procedohet në Qeveri me ç'rast do përcaktohen më saktë objektivat, vizioni dhe politikat e ministrisë.

Në të ardhmen synohet edhe përpilimi i një ligji të veçantë për zhvillim rajonal. Sa i përket të gjeturave në lidhje me mosprotokollimin e faturave, problemi qëndron në faktin se libri i faturave nuk ka qenë i vulosur, mirëpo, të gjitha faturat ekzistojnë. Arsyeja e mosvulosjes është se ministria ka një staf prej shtatë shërbësve civilë, por pas rekomandimit të auditorit është krijuar plani i veprimit dhe tani çdo faturë regjistrohet dhe vuloset, dhe rasti nuk do përsëritet. Sa i përket inventarizimit të pasurisë gjatë kohës së auditimit, raporti nuk ka qenë i përfunduar. Lidhur me kriteret për shpërndarjen e subvencioneve, ministria ka një udhëzim administrativ, ku janë të paracaktuara kriteret për shpërndarjen e subvencioneve. Ministria për momentin po përpilon dy dokumente; e para ka të bëjë me profilet rajonale ekonomike, dhe e dyta ka të bëjë me indikatorët socio-ekonomikë, dokumente të cilat do shërbejnë si bazë për vlerësimin e nevojave në vitin e ardhshëm.

Avdullah Hoti, theksoi se Raporti i auditorit thekson qartë se janë gjithsej 36 pagesa të testuara nga mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale, me vlerë 1.5 milion, faturat e të cilave nuk janë protokolluar dhe as që është shënuar numri rendor i protokollit.

Erëmira Bytyci- Pllana- ZKA, tha se sa i përket çështjes që lidhet me mosprotokollimin e faturave, siç theksohet në raport, këto fatura, sipas rregullave financiare, kërkohet që fatura e cila pranohet, të protokollohet dhe të evidentohet. Ministria ka pasur një libër ku janë shënuar pranimet e faturave por jo numrat rendorë të protokollit.

Nait Hasani, kërkoi nga Ministri të përgjigjet për investimet që i ka bërë, ku i ka bërë, a ka përgjegjësi dhe a ka shkelje dhe theksoi se këto janë çështjet që duhet të trajtohen.

Avdullah Hoti, theksoi se fjalën e fundit për shpenzimet publike e jep auditori dhe në fund ministri e bashkëngjit një letër me të cilën pajtohet me të gjeturat e raportit. Dhe çdo e gjetur nuk duhet të kontestohet.

Etem Arifi, e përgëzoi ministrinë për krijimin e 561 vendeve të reja për punësim dhe beson se mjetet për investime kapitale nuk janë keqpërdorur. Sa i përket thirrjeve për projekte, ministri nuk mund ta marrë rolin e hetuesit se ku po shkojnë mjetet.

Kryetari, kërkoi nga ministria që për periudhën tetor 2017 deri në qershor 2019 t'i përgatisë informacionet e detajuara rreth shumës së buxhetit për grande dhe subvencione dhe listën e përfituesve. Ky raport kërkohet që të përgatitet për një periudhë sa më të shkurtër.

Sekretari i MZHR-së, tha se Ministria ka përgatitur raportin për investime kapitale për vitin 2018, raport i cili është i publikuar edhe në ueb-faqen e ministrisë si dhe është hartuar një analizë për shpërndarjen e graveve për vitin 2018. Në këto raporte janë përshkruar në detaje shumë monetare, përfituesit dhe objektivat e arritura. Këto raporte do t'ia përcjellë komisionit në mënyrë elektronike.

Emilija Rexhepi, vuri në pah faktin se ka tendenca që diskutimi të zhvendoset në konfliktin politik në mes dy subjekteve politike, por kjo s'ka të bëjë me këtë por me keqpërdorimin e parasë publike. Deputetja kërkoi përsëri me ngulm që për të gjithë emrat që i ka përmendur paraprakisht dhe që janë përfitues të granateve, shumica e të cilëve ose janë të afërt ose janë anëtarë të partisë dhe nga ministrit kërkon që të ketë përgjigje me shkrim dhe të ketë dokumente për secilin rast të mbështetur me fakte.

Albert Kinolli, tha se dëshiron të dijë nëse emrat të cilët i përmendi deputetja Rexhepi, a janë qytetarë të Republikës së Kosovës dhe se a ka evidentuar ZKA-ja shkelje gjatë vlerësimit.

Ministri i MZHR-së tha se gjatë këtij diskutimi u informua që paska një numër të madh nga komuniteti boshnjak, që paskan përfituar grande. Ministria është shumë transparente, për këtë arsye do merren në pyetje. Po ashtu, nëse ka raste ku palët kanë aplikuar dhe ministria apo komisioni ua ka pamundësuar përzgjedhjen, përkundër kriterëve të plotësuar, lut komisionin që ta njoftojnë dhe ministria do jetë e gatshme të marrë përgjegjësi.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që raporti i auditimit për PVF- të e MZHR-në për vitin 2018, mos të adresohet për në Seancë Plenare, rekomandimet do t'i adresohen ministrit të MZHR-së.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018;

Kryetari, theksoi se ZKA-ja ka dhënë opinion të kualifikuar me theksim të çështjes, për raportin e PVF-së për Zyrën e Kryeministrit. Ai tha se baza e opinionit lidhet me disa çështje, ku si më kryesorja ka të bëjë me vendimin e Qeverisë për themelimin e një task forcës me emrin "Ta pastrojmë Kosovën"

për periudhën 15 shtator – 15 dhjetor 2018 dhe se vlera e projektit ishte 815,035€. Për realizimin e këtij projekti janë anashkaluar procedurat për subvencionimin e OJQ-ve, të cilat janë të përcaktuara sipas kritereve, standardeve dhe procedurave të financimit të OJQ-ve. Z. Selmanaj theksoi parregullsitë e gjetura nga ZKA-ja, ku përmendi sa Zyra e Kryeministrit nuk ka kontratë të nënshkruar me OJQ-në përfituese të projektit dhe se në bazë të planit të aktiviteteve, Ministria e Ambientit dhe Mjedisit do të duhej të merrej me alokimin e mjeteve financiare të projektit, ndërkaq ZKM-ja do të angazhohej vetëm në pjesën ceremoniale të saj. Por, në këtë rast, ZKM-ja ka kryer të gjitha pagesat, ku për bazë ka marr vetëm faturat e dorëzuara nga OJQ-ja përfituese dhe nuk ka raport financiar dhe narrative të dorëzuar nga ana e OJQ-së. Gjithashtu, z. Selmanaj tha se në fund të aktiviteteve të këtij projekti, MMPH-ja e ka dorëzuar një raport përmbledhës për punët e kryera gjatë këtyre tre muajve, por jo edhe ndonjë raport financiar dhe ndonjë raport përshkrues për shpërndarjen e disa artikujve, siç janë kontejnerët dhe shportat. Ai tha se më shqetësues është fakti se për këtë projekt dhe për këtë organizatë parashihej edhe në vitin 2019, financimi i shumës përafërsisht të njëjtë e që si total i bie diku 1.600 000 euro. Çështje tjetër është edhe financimi i shpenzimeve të rivarrimit, ku janë shpenzuar mjete financiare në shumë prej 32,000 €, pa procedura të prokurimit. ZKM-ja kishte një kontratë me një operator ekonomik për rivarrimin e heronjve dhe për të cilën ka aplikuar të gjitha procedurat e prokurimit. Por, për të njëjtat shërbime ishte kontraktuar një operator tjetër. Lidhur me këtë rast, shpenzimet janë kryer pa aplikuar procedura të prokurimit dhe me çmime më të larta krahasuar me çmimet e OE me të cilin ZKM-ja kishte kontratën e mëhershme. Lidhur me këtë çështje z. Selmanaj ka kërkuar shpjegime shtesë nga zyrtarët e ZKM-së.

Lidhur me çështjen e buxhetit për shpenzime kapitale është realizuar rreth 97%, konstatim ky i nxjerrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit, buxhet ky që përfshin 12 projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe asnjë projekt për vitin aktual. Të gjitha projektet i përmbushin kushtet të trajtohen si buxhete kapitale, prandaj nga kategoria e buxheteve kapitale, janë paguar edhe furnizime dhe shërbime veterinare që për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime dhe subvencione dhe kërkoi sqarime edhe për këtë pjesë.

Z. Selmanaj ka kërkuar shpjegime edhe për çështjen që lidhet me të punësuarit me marrëveshje të veçanta, ku nga pesë mostrat e vlerësuara nga ZKA-ja, është vërejtur se në tri raste nuk janë aplikuar procedurat e rekrutimit për marrëveshje për shërbime veçanta.

Çështja e fundit e ngritur nga z. Selmanaj, ishte ajo lidhur me transferet dhe subvencionet, kategori kjo që buxhetin final për vitin 2018 e kishte 3,710, 633 euro. Ndërkohë ky kod buxhetor është rritur me vendim të Kryeministrit. Duke e ditur se buxheti për transfere dhe subvencione menaxhohet nga Zyra për Çështje të Komuniteteve dhe programi Zyra e Kryeministrit. Këto kanë të bëjnë për subvencionimin e aktiviteteve për entitete jopublike. Ai theksoi, se nga Zyra për Çështje të Komuniteteve, është financiar po e njëjta organizatë e lartpërmendur për aktivitetin “Ta pastrojmë Kosovën” në vlerë prej 30,000 euro, dhe se duke u bazuar në rregulloren për mbështetje dhe subvencionimin e OJQ-ve nuk lejohet që për projektin e njëjtë të ketë burim financimi nga dy institucione publike. Gjithashtu, ai specifikisht përmendi dy projekte për dy organizata që në raport të ZKA-së është gjetur se kanë pasur dy burime të financimit për projektin e njëjtë. Njëri ka të bëjë me aktivitetin “Integrimi i Goranëve të rinj”, OJQ përfituese nga Kuvendi i Kosovës me datën 14.5.2018 ka marrë subvencion 4,995€, si dhe me datën 20.12.2018 nga ZÇK (Zyra për Çështje të

Komuniteteve) e ZKM-së, shumë prej 5,000€. Në të dy rastet pagesat janë bërë për të njëjtin aktivitet. Ndërsa rasti tjetër ka të bëjë me aktivitetin “Promovimi i diversitetit kulturor dhe dialogu” nga MKRS-ja me datën 30.4.2018 OJQ përfituese është subvencionuar me 3,980€, ndërsa nga ZÇK-ja me datën 20.12.2018 ka marrë edhe 15,000€, për të njëjtin aktivitet Ai përmendi se në funksion të kësaj zyreje ka marrë në dhënien dhe monitorimin e subvencioneve. Sekretari i përgjithshëm i ZKM-së duhet të themelojë komisionin për shqyrtimin e kërkesave dhe projekteve për ndarjen e subvencioneve për personat fizikë dhe juridikë. Për 51 raste të personave fizikë me pagesë totale prej 318,500€, nuk është formuar komision për vlerësimin e këtyre kërkesave, edhe pse vendimet janë të nënshkruara nga Kryeministri. Por edhe në rastet kur është formuar komisioni vlerësues ka pasur shkelje të evidentuara, ku është dhënë subvencion për financim të roletave dhe fasadave. Me gjitha këto çështje të ngritura z. Selmanaj përfundoi raportimin dhe kërkoi shpjegime nga zyrtarët e ZKM-së për të gjitha çështjet e përmendura.

Fitim Krasniqi, tha se ne kemi pranuar raportin e auditorit, dhe se të gjitha të gjeturat i kemi pranuar si të sakta dhe e kemi hartuar planin e veprimit, të cilin duhet ndjekim për të adresuar të gjitha të gjeturat e auditorit gjeneral si dhe e kemi hartuar planin të cilin duhet ta ndjekin edhe agjencitë e tjera që janë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Sa i përket çështjes të projektit “Ta pastrojmë Kosovën”, ai tha se OJQ-ja përfituese ka parashtruar kërkesën drejtuar ZKM-së për fillimin e procedurave për krijimin e task forcës, dhe si rrjedhojë është krijuar task forca me përbërje prej 12 anëtarëve, e cila udhëhiqet nga zotëri Fatmir Matoshi, ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Por që më vonë në mbledhjen e 62-të të Qeverisë, ministri ka kërkuar që projekti në vlerë prej 850,000 euro, të realizohet përmes kësaj organizate “Let’s do it Kosova” për shkak të procedurave të tejzgjatura. Kjo kërkesë e ministrit është aprovuar me vendim të Qeverisë pa asnjë votë kundër, dhe më pas Ministria e Financave ka derdhur fondet në kodin e Zyrës së Kryeministrit dhe jo tek MMPH-ja. Sekretari thekson se përkundër insistimit të tij që këto mjete të kthehen mbrapa, nuk është arritur që të shfuqizohet ky vendim dhe ka mbetur përgjegjësi e ZKM-së që të monitorohet ky projekt. ZKM-ja në fund ka pranuar një raport të shpenzimeve për këtë projekt.

Kryetari, yeti se kush kujdeset që të zbatohet rregullorja për kriteret dhe standardet për procedurat e financimit të OJQ-ve? Kush merret me krijimin e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të projekteve? Kush e ka bërë vlerësimin që kjo OJQ të marrë 850, 000 euro?

Fitim Krasniqi, theksoi se ZKM-ja nuk është marrë me asnjë procedurë pasi që ka qenë përgjegjësi e Ministrisë së Ambientit që t’i zhvillojë procedurat e këtij projekti. Ai tha se ai si sekretar i ZKM-së nuk ka bërë asnjë kërkesë për marrjen e kësaj përgjegjësie në kuadër të organizatës së tij.

Kryetari, pyet nëse ka pasur edhe me herët kësi lloj praktike, ku një organizate vjen dhe kërkon financim 850, 000 euro për një projekt dhe në mënyrë arbitrare ta meritojë këtë financim. Gjithashtu, ai propozoi që të ftohet ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe koordinatori i projektit që të diskutohet lidhur me këtë çështje.

Avdullah Hoti, tha se nuk e sheh të nevojshme që të ftohen në diskutim ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pasi që vendimi për financimin e OJQ-së në fjalë është vendim drejtpërdrejt i Qeverisë për ndarjen e 850,000 eurove jashtë procedurave. Ai sugjeron se duhet të shohim përgjegjësinë politike tek Kryeministri dhe tek Qeveria, dhe jo tek zyrtarët e pranishëm me që këta janë të vetëdijshëm se si janë procedurat dhe se me çfarë rigoroziteti trajtohet çdo shpenzim që është realizuar. z. Hoti theksoi se si komision kemi pasur një praktikë që raportet të cilat kanë qenë problematike dhe që nuk është arritur që të qartësohen deri në fund, janë dërguar në Seancë Plenare.

Kryetari, tha se ky problem bëhet akoma më i madh pasi që projekti po vazhdon edhe në vitin 2019.

Emilija Rexhepi, falënderoi auditorët e Zyrës Kombëtare që për herë të parë me rastin e auditimit të pasqyrave financiare të ZKM-së për vitin 2018 kanë audituar edhe vendimet e Qeverisë të cilat në një formë apo tjetrën kanë ndikuar në opinionin e auditimit dhe Zyrës së Kryeministrit. Ajo përmendi rastin e projektit “Ta pastrojmë Kosovën”, ku një shumë jashtëzakonisht e madhe e mjeteve, mbi 800 mijë euro janë ndarë nga rezerva e Qeverisë në ZKM, ndërsa menaxhimi i projektit ishte detyrë e MMPH-së. Po ashtu, përmendi faktin që vitin e kaluar Zyra për çështje të Komunitete në kuadër të ZKM-së ka treguar që nuk është vetëm zyre e komunitetit serb, por edhe e komuniteteve të tjera që punojnë dhe jetojnë në Kosovë. Nga kjo shfrytëzoi rastin që me rishikim të buxhetit të ndahen mjete buxhetore më tepër për këtë program me kusht që të kenë përfitime sa më shumë komunitetet.

Fitim Krasniqi, tha se sa i përket çështjes që ka rekomanduar auditori, menjëherë është kërkuar që Zyra e Komunitete dhe drejtori ta shfuqizojnë marrëveshjen në fjalë dhe kjo marrëveshje është ndërprerë dhe organizata nuk ka fare mjete. Ai ka vazhduar sqarimet lidhur me të gjeturën e dytë, që ka të bëjë me rivarrimin e heronjve dhe dëshmorëve, ku ai thekson se ZKM-ja ka një marrëveshje valide për rivarrimin e të pagjeturve dhe se i ka respektuar të gjitha procedurat e nevojshme të prokurimit për këtë kontratë. Mirëpo, kjo kontratë nuk ka përfshirë rivarrimet, rregullimet e hapësirës së varrezës, infrastrukturën përcjellëse dhe rregullimin e varrit sipas kërkesës që ka ardhur nga kabineti dhe nga vendimi i Qeverisë së Kosovës. Prandaj, kontrata aktuale që ZKM-ja ka pasur, nuk është mundur që të përdoret për rastin e varrimit të dëshmorëve, siç edhe është përmendur në raportin e auditorit. Kjo për arsye se kjo kontratë nuk ka arritur që të përballojë as vlerën kontabël të projektit. Në pamundësi të afatit kohor për të zhvilluar të gjitha procedurat tenderuese, kabineti dhe Qeveria kanë marrë vendim që t’i procedoj tutje shpenzimet me vendime të Qeverisë.

z. Krasniqi ka vazhduar sqarimin lidhur me çështjen për kontratat për shërbimet e veçanta, ku tha se një numër i madh i tyre janë bërë për agjencitë e veçanta të cilat i përgjigjen direkt Kryeministrit, në periudha të shkurtra 3-6 muaj. Ai përmendi se numri më i madh i këtyre kontratave është tek Agjencia e statistikave, ku janë rreth 60 pozita dhe një pjesë tek Agjencia e Ushqimit. Tek Zyra e Kryeministrit ka qenë një numër i vogël e ku është llogaritur edhe Komisioni për shënimin e demarkacionit dhe këto nuk kanë qenë kontrata të veçanta, por janë vendime të nënshkruara nga Kryeministri i Kosovës. Ai tha se në përgjithësi janë respektuar procedurat e rregullores për shpalljet publike që janë bërë edhe ia kaloi fjalën drejtorit të Zyrës për Komunitete për të dhënë sqarime lidhur me çështjet e subvencioneve dhe transfereve me që është përgjegjës për këtë pjesë kurse për çështjet e tejkalimit të blerjeve kapitale ia kaloi fjalën kryeshefit të zyrës.

Kryetari, kërkoi sqarime për 51 personat fizikë, ku nuk është themeluar komision iu janë ndarë 318,000 euro dhe nënshkruhen nga Kryeministri si dhe çështja që ka të bëjë me OJQ-në që merr dy subvencione për aktivitetin e njëjtë.

Ivan Milojeviq, tha se është e vërtetë që është ndarë një shumë prej 180,000 euro për person fizikë të cilët kanë qenë pjesë e komuniteteve joshumicë dhe kjo ka ndodhur në fillim të vitit 2018. Po ashtu, me proces të rishikimit të buxhetit është mbushur ky buxhet, aktivitetet kanë qenë të njëjta, megjithatë kanë qenë të ndryshme.

Kryetari, pyeti se përse nuk është themeluar komisioni për të vlerësuar kërkesën për 318,500 euro për t'iu dhënë këtyre 51 personave fizikë. Gjithashtu, pyeti se kush i bënë vlerësimet dhe mbi çfarë baze bëhen ato?

Ivan Milojeviq, theksoi se në kushte normale për secilën ndarje të subvencioneve krijohet një komision për shqyrtim dhe analizim të kërkesave. Në rastin konkret, ne kemi pasur një vendim të komisionit të ndarjes për këta 51 përfitues dhe ne si drejtori vetëm e kemi ekzekutuar ndarjen.

Qerkin Bytyqi, zyrtar i Zyrës Kombëtare të Auditimit, tha se Zyra kombëtare para ardhjes në konkluzion kan shqyrtuar të gjitha aspektet dhe se për dy javë rresht ZKM-ja ka shqyrtuar raportin e auditorit për të parë se a qëndrojnë këto fakte apo jo. Prandaj, konsiderojmë se kjo e gjetur është e qëndrueshme.

Kryetari, pyeti përse është parë e rëndësishme që ZKM-ja të bëjë financimin e projektit për blerjen e roletave dhe zbukurimin me fasadë dhe se kush është përfitues i projektit?

Ivan Milojeviq, tha se po është e vërtetë se Zyra për Çështje të Komuniteteve bënë ndarje të subvencioneve për persona fizikë e jo për OJQ-të. Në rastin konkret, ne kemi ndarë mjete për objekte të banimit, përfshirë këtu edhe për banjot dhe financimin e izolimit dhe fasadimin e shtëpive. Por, unë personalisht nuk kam njohuri për financim të roletave në kuadër të këtij projekti.

Kryetari, pyeti lidhur me dy rastet, ku OJQ-të marrin financime prej dy institucioneve për të njëjtin aktivitet, pse ndodh kjo përkundër që është e ndaluar me ligj në Kosovë?

Ivan Milojeviq, tha se Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të ZKM-së jep llogari vetëm për shumën e mjeteve që i ka të planifikuara në buxhet, por në asnjë mënyrë nuk ka informata për format dhe mënyrat e financimit të projekteve të ndryshme nga institucionet e ndryshme. Në rastin konkret, Zyra për Çështjen e Komuniteteve nuk mund ta luaj rolin e një inspektori.

Fitim Krasniqi, sqaroi çështjen e ngritur për financimet e dyfishta të OJQ-ve, ku theksoi se menjëherë pas marrjes së rekomandimeve nga ZKA-ja ai ka formuar komision të veçantë që të shqyrtojë këto raste. Ai ka marr raportin e detajuar të cilin tashmë e ka përcjellë edhe tek ZKA-ja dhe të njëjtin do ta përcjellë edhe tek KMFP-ja. Ky raport ka analizuar secilin dokument të OJQ-ve përfituese, dhe tek rasti i financimit të projektit “Integrimi i Goranëve të rinj” e njëjta OJQ ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Kuvendin në lidhje me projektin “Shënimi i ditës së Goranëve”. Komisioni ka dal me konkluzionin se këto dy projekte janë me tituj dhe aktivitete të ndryshme dhe se mbanë përgjegjësi të plotë për këtë konkluzion. Për këtë arsye nuk është e qëndrueshme e dhëna nga ZKA-ja. Ndërsa tek rasti i dytë, ku OJQ-ja ka përfituar financim nga MKRS-ja dhe nga Zyra për Komunitete. Komisioni ka analizuar projektin e financuar nga Zyra për Komunitete dhe aty parashihen aktivitete për komunat Fushë-Kosovë, Graçanicë, Novobërdë dhe Kamenicë. Ndërsa, projekti i financuar nga MKRS-ja ka

paraparë aktivitete në komunat Prizren, Fushë- Kosovë dhe Vushtrri. Si rezultat, këto projekte janë të ngjashme në tituj të projekteve por të implementuara në komuna të ndryshme.

Etem Arifi, tha se financimet të cilat bëhen për komunitetin ashkali janë të vogla por që është e rëndësishme se komuniteti është duke fituar sadopak nga kjo qeverisje në krahasim me atë të kaluarën ku përfitimet kanë qenë shumë më të vogla.

Avdullah Hoti, sqaroi se në Ligjin e Buxhetit të vitit 2015-2017 është neni i cili thotë se mjetet nga Zyra e Komuniteteve do të ndahen në bazë të kërkesë që vijnë nga komunitetet e ndryshme, në bazë të një planifikimi paraprak, për të siguruar që subvencionet të ndahen mbi bazat e nevojave dhe gjitha komunitetet të jenë të përfaqësuar.

Emilija Rexhepi, theksoi se pjesa e buxhetit me shuma të mëdha të mjeteve shkon tek komuniteti serb, ndërsa pjesa e buxhetit me shuma të vogla, përfitues janë edhe komunitetet tjera. Dhe në fakt pajtohem me konstatimin e drejtorit për çështje për komunitete se përfitues janë gjitha komunitetet.

Albert Kinolli, falënderoi gjithë aktorët e përfshirë në procesin për financimin e nevojave të komuniteteve pakicë për mirëkuptimin e ndërsjellët që kanë dhe theksoi se raporti i auditorit për vitin 2019, pret që të jetë edhe më i mirë për shkak se rekomandimeve aktuale do ta përmirësojë punën e zyrës. Por po ashtu ai parashtrroi edhe një kërkesë në emër të komunitetit RAE dhe TG që Zyrës për Çështje të Komuniteteve t'i shtohet buxheti për shkak se këtu bëhet fjalë për jetesën e mijëra njerëzve që vijnë nga gjashtë komunitetet.

Kryetari, shtroi dy pyetje; njëren lidhur me tejkalimet e vlerës së kontratës tek agjencia dhe tjetra lidhur me zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar.

Valdet Gjinovci, lidhur me tejkalimin e vlerës së kontratës, sqaroi çështjen e sëmundjes gungore që ka ndodhur tek gjedhet, si pasojë e të cilës kanë ngordhur 1.563 krerë, për të cilat është bërë edhe kompensimi. Ai theksoi se kontrata ka qenë e paraparë për tri vite dhe se në vitin e parë, pas vaksinimit sëmundja do të eliminohet por që në bazë të rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Shëndet të Kafshëve dhe mbrojtjes së konsumatorëve nga Digjestantët në Komisionin Evropian është rekomanduar që të vazhdohet edhe për dy vitet e ardhshme. Si rrjedhojë është tejkaluar vlera e kontratës, meqë ka qenë e obligueshme që të zbatohen rekomandimet dhe të çrrënjohet sëmundja si e tillë.

Sa i përket çështjes për zbatimin e rekomandimeve, ai tha së janë krijuar disa komisione dhe për pjesën e rekomandimeve për subvencioneve punët e komisionit janë përfunduar dhe është konkluduar se nuk ka ndonjë konflikt dhe se nuk qëndrojnë ato të dhëna që kanë dalë nga ana e ZKA-së me fakte konkrete të cilat do të përcillen edhe tek ZKA-ja.

Sa i përket projektit “Ta pastrojmë Kosovën”, është duke u punuar në raportin financiar dhe atë narrativ dhe sa më parë që të përfundohet do të bëhet publik dhe do të përcillet tek ZKA-ja dhe KMFP-ja.

Kryetari, kërkoi që plani i veprimt që do të bëhet për vitin në vijim të përcillet sa më parë tek KMFP-ja.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare për ZKM-në për vitin e përfunduar më 31.12.2018 të mos adresohet për seancë plenare. Rekomandimet do të adresohen vetëm për institucionin e audituar.

5. Të ndryshme.

Për mbledhje e radhës së Komisionit, për të martën planifikojmë t'i shqyrtojmë dy raporte: Raportin e Auditimit të Ndërmarrjes Publike Kompania Regjionale e Ujitjes "Drini i Bardhë" sh.a për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 (raportues Mërgim Lushtaku) dhe Raportin e Auditimit për PVF-të e KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018. (raportues Avdullah Hoti).

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Driton Selmanaj